

## Vendim nr. 195 datë 24.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, anëtarë, në datën 24.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 25 (A) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ARBEN GJATA**, përfaqësuar nga avokat Ermir Beta, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 49 akti, datë 23.06.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 102, datë 18.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 44, datë 04.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-116, datë 25.01.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I

### Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Arben Gjata (*kërkuesi*) ka qenë anëtar i komisionit të ngritur me urdhër të ministrit të Shëndetësisë për dhënien e koncensionit “Për shërbimet e integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”.

2. Në datën 13.01.2020 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), mbi bazën e një kallëzimi penal, ka regjistruar procedimin penal nr. 13 për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 248-25, 258-25 dhe 260 të Kodit Penal (*KP*), në lidhje me procedurën e dhënies me koncesion të shërbimit të sterilizimit.

3. Me vendimin nr. 49, datë 23.06.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme*), mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, ka vendosur të caktojë ndaj personit nën hetim Arben Gjata, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248-25 dhe 186/3-25 të *KP*-së, masën e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), dhe urdhërimin e tij që të paraqitet përpara oficerit të policisë gjyqësore, një herë në javë, ditën e premte, ora 15:30.

4. Me vendimin nr. 102, datë 18.08.2023, Gjykata e Posaçme ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 49, datë 23.06.2023 të po asaj gjykate dhe detyrimin e tij për t’u paraqitur përpara oficerit të policisë gjyqësore të premten e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

5. Me vendimin nr. 44, datë 04.10.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*), ka vendosur të miratojë vendimin e mësipërm të Gjykatës së Posaçme për personin nën hetim Arben Gjata. Në vlerësimin e asaj gjykate, Gjykata e Posaçme ka vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 228-230

të KPP-së dhe vendimet janë të arsyetuara, sipas neneve 245, pika 1 dhe 112, pika 3, të KPP-së e nuk ka shkaqe pavlefshmërie. Sipas Gjykatës së Posaçme të Apelit, masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e parashikuar nga neni 234 i KPP-së, është masa proporcionale, e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit në raport me natyrën dhe rëndësinë e fakteve penale dhe sanksionit të veprës penale që dyshohet se ka kryer kërkuesi. Gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë edhe argumentin e dhënë nga Gjykata e Posaçme në vendimin nr. 102, datë 18.08.2023, që ka konfirmuar masën e sigurimit të caktuar me vendimin nr. 49, datë 23.06.2023 të Gjykatës së Posaçme, por duke caktuar detyrimin për paraqitjen në policinë gjyqësore jo çdo javë, por një herë në dy javë, duke mos e penguar kërkuesin në angazhimet profesionale. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin nr. 00-2024-116, datë 25.01.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, duke vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural penal, neneve 228-230 të KPP-së, në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, si dhe të vendimit unifikues nr. 7/2011. Sipas Kolegjit Penal, në rekurs nuk konstatohen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së për cenimin e vendimit dhe gjykatat e posaçme kanë bërë një arsyetim të plotë të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal, si dhe kanë analizuar pretendimet që janë ngritur në rekurs, duke u dhënë përgjigje atyre. Edhe pretendimin për cenimin e nenit 71 të KPP-së, pasi procedura e dhënies me koncesion është një procedurë administrative që është vlerësuar e ligjshme nga organi kompetent administrativ, Kolegji Penal e ka vlerësuar të pabazuar, duke arsyetuar se në rastin konkret nuk gjen zbatim kjo dispozitë dhe, për më tepër, hetimi nuk varet dhe as nuk ndikohet nga procedura administrative, e cila ka verifikuar pretendimet e një shoqërie në raport me të drejtat e saj, por jo në raport me faktet penale që po hetohen në këtë rast. Sipas Kolegjit Penal, caktimi i masës së sigurimit është në raport të drejtë me proporcionalitetin e nevojës së masës së sigurimit me faktin penal, referuar mënyrës dhe rrethanave të kryerjes së tij dhe nga gjykatat e posaçme nuk ka pasur mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk rezulton që vendimet e kundërshtuara të jenë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 14.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 26.06.2024.

8. Kolegji i Gjykatës në datën 16.09.2024, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

9.1.1. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykatat nuk kanë analizuar kompetencën e organit procedues (prokurorisë/gjykatës penale) për të kontrolluar veprimtarinë administrative (tërësia e veprimeve dhe akteve administrative), e cila ka një natyrë përfundimtare dhe nuk është shfuqizuar nga asnjë organ i parashikuar me ligj. Procedimi penal i kërkuetit si funksionar publik është bazuar në vlerësimin e një akti/grup aktesh administrative që janë të formës së prerë, pra të ekzekutueshme dhe prodhojnë pasoja juridike (kontrata si produkt final i veprimtarisë administrative në hetim e cila është në fuqi, e pacenuar nga një asnjë organ). Ligjshmëria e veprimtarisë së nëpunësit të administratës kontrollohet bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*), vetëm nga organi që ka nxjerrë aktin, nga organi epror dhe gjykata administrative. Aktet administrative objekt hetimi nuk janë cenuar nga organet kompetente për kontrollin e tyre, ndaj ato kanë fuqinë e një akti të ligjshëm përfundimtar që nuk mund të vihet në dyshim nga asnjë organ tjetër. Arsyetimi i Kolegjit Penal në paragrafin 38.3 të vendimit, që nuk konsideron të formës së prerë një vendim administrativ të formës së prerë, bie ndesh me këtë parim dhe standardin e arsytimit, si dhe krijon precedent të rrezikshëm dhe pasiguri juridike.

- 9.1.2. Kërkuesi i është nënshtruar një mase sigurimi për një veprim administrativ që e ka kryer në cilësinë e përfaqësuesit të organit publik. Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” nga ana objektive shfaqet me kryerjen apo moskryerjen e një veprimi administrativ dhe që bie në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që KPA-ja parashikon se çfarë konsiderohet veprim administrativ, akt administrativ dhe kur ato janë të pavlefshme, si kontrollohen dhe nga kush shpallen të tilla (nenet 98, 99 e vijues të KPA-së). Vendimet gjyqësore nuk kanë evidentuar se cili organ i ngarkuar nga ligji për të kontrolluar veprimtarinë administrative e ka konsideruar atë të paligjshme. Pavarësisht se ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” (*ligji nr. 125/2013*) ka parashikuar në mënyrë specifike organet që kanë detyrimin të kontrollojnë veprimtarinë e komisionit të koncesionit, asnjë prej tyre nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë veprimtari dhe nuk ka asnjë vendimmarrje administrative me efekt shfuqizues/riparues të saj, përkundrazi, ajo është miratuar edhe nga Ministria e Financave si organi i ngarkuar me ligj për verifikimin e eficiencës ekonomike dhe bazueshmërisë financiare të projektit. Për sa kohë që për veprimet administrative objekt hetimi nuk është ngritur asnjë padi administrative për shfuqizimin e tyre brenda afateve ligjore, ato janë përfundimtare, pra as gjykata penale nuk mund t’i hyjë vlerësimit të tyre.
- 9.1.3. *Standardit të arsytimit*, pasi vendimet gjyqësore nuk përmbajnë asnjë evidentim, trajtim dhe vlerësim se cilat janë dispozitat ligjore të shkelura nga kërkuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative si anëtar i komisionit të dhënies me koncesion. Në rastin konkret, mungon trajtimi se si është provuar ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale si kusht i domosdoshëm për marrjen e masës së sigurimit.
- 9.2. *Parimin e sigurisë juridike*, pasi pavarësisht parashikimit të nenit 152 të KPP-së, gjykatat i kanë dhënë vlerë të paracaktuar kërkesës së prokurorisë për marrjen e masës së sigurimit ndaj kërkuesit ashtu edhe raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (*KLSH*), të cilat nuk konsiderohen as akte administrative dhe aq më pak që mund të prodhojnë pasoja riparimi të vendimmarrjeve administrative. Ky parim është cenuar edhe nga vlerësimi i Kolegjit Penal në paragrafin 38 të vendimit lidhur me pretendimin se kjo çështje është hetuar një herë nga Prokuroria e Tiranës, e cila, me

vendimin e datës 19.09.2016, ka vendosur pushimin e çështjes dhe gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë nenin 329/c të KPP-së. Kallëzimi mbi bazën e të cilit ka nisur procedimi penal mbi bazën e të cilit është caktuar masa e sigurimit personal ndaj kërkuesit nuk kishte bashkëlidhur asnjë provë të re që të tregonte se vendimi i pushimit nuk ishte i bazuar. Po kështu, gjyqtari i seancës paraprake nuk ka marrë vendim për revokimin e vendimit të pushimit dhe vetëm pasi u regjistrua çështja dhe rifilluan hetimet filloi edhe një herë mbledhja e provave të njëjta me ato të mbledhura më parë dhe që ekzistonin që në procedimin e mëparshëm, i cili është pushuar. Raportet e KLSH-së nuk përbëjnë provë të re, pasi në to jepen thjesht mendime, rekomandime që kanë ekzistuar edhe gjatë procedimit të parë të pushuar dhe janë administruar nga prokuroria në atë kohë. Ndërkohë që kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme që në këtë rast të zbatohet neni 329/c i KPP-së, kjo dispozitë nuk është marrë në konsideratë dhe as nuk është referuar dhe argumentuar se përse nuk gjen zbatim në rastin konkret.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë,

mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprahe çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Për këtë arsye, mjetet juridike në dispozicion nuk përfshijnë vetëm ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, por çdo ankim ose kundërshtim, duke u ofruar mundësi organeve publike dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të luajnë rolin e tyre subsidiar për t’i garantuar individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm, ndërkohë që ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm. Bazuar në këtë qasje, Gjykata, në mënyrë përjashtimore, ka bërë pjesë të kontrollit kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen këto kritere: (i) vendimi duhet të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar ose, e thënë ndryshe, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes së të drejtës kushtetuese; (ii) vendimi të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi duhet të ketë një

masë autonome nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (shih vendimet nr. 22, datë 04.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin e vendimeve me natyrë jo përfundimtare që jepen gjatë një procesi gjyqësor, Gjykata, bazuar në përmbajtjen e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe qëllimin e natyrën e ankimit kushtetues individual, ka vlerësuar nëse të tilla vendime, pavarësisht karakterit të tyre, janë, *së pari*, të afta të prekin të drejta themelore të individit dhe, *së dyti*, cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit (shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Mbi këtë qasje, Gjykata ka bërë pjesë të kontrollit të saj vendimet e fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë (shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese), vendimet për caktimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, që jepen në procedura të veçanta në funksion të procedimit penal të themelit (shih vendimet nr. 47, datë 26.07.2012; nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese), vendimet gjyqësore për vendosjen e masës së sekuestros preventive mbi pasuri të individit (shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese), apo edhe vendimet me të cilat gjykatat më të larta kanë vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatat më të ulëta (shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Duke iu kthyer rastit konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ajo është vënë në lëvizje për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimeve gjyqësore që kanë caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të premtën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 10:00. Duke qenë se këto vendime, për nga natyra e tyre janë të ndërmjetme, jo përfundimtare, për sa kohë janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, Mbledhja e Gjyqtarëve do të ndalet në verifikimin e plotësimin të kriterëve si më sipër, që lejojnë, përjashtimisht, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

16. Për sa i përket kriterit të parë, pra që vendimi të vendosë mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar dhe shkelja të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e tij, Mbledhja e Gjyqtarëve do të vërë në diskutim natyrën e së drejtës së pretenduar të shkelur, ashtu edhe pasojat e drejtpërdrejta



të ardhura në këtë të drejtë nga shkelja e pretenduar, me qëllim verifikimin nëse vetë e drejta apo pasojat e ardhura kanë mundësi të riparohen gjatë procesit të themelit në gjykatat e zakonshme.

17. Për sa i përket së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi i ka ngritur pretendimet e tij në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt, në disa aspekte të saj, ashtu edhe të parimit të sigurisë juridike. Sipas kërkuesit, është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e lidhur kjo me kompetencën e prokurorisë/gjykatës për të kontrolluar veprimtarinë administrative (tërësia e veprimeve dhe akteve administrative), pasi, për sa kohë që aktet administrative objekt hetimi nuk janë cenuar nga organet kompetente për kontrollin e tyre (organi që ka nxjerrë aktin, organi epror dhe gjykata administrative), ato kanë fuqinë e një akti të ligjshëm përfundimtar që nuk mund të vihet në dyshim nga asnjë organ tjetër, pra as nga gjykata penale. Sipas tij, edhe bazuar në ligjin nr. 125/2013, asnjë nga organet që kanë detyrimin të kontrollojnë veprimtarinë e komisionit të koncesionit nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë veprimtari, nuk ka ndonjë vendimmarrje administrative me efekt shfuqizues/riparues dhe as nuk është ngritur ndonjë padi administrative për shfuqizimin e veprimeve administrative objekt hetimi. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, duke qenë se vendimet gjyqësore nuk kanë evidentuar dhe trajtuar se cilat janë dispozitat ligjore të shkelura prej tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative si anëtar i komisionit të koncesionit, ashtu edhe në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale, si kusht i domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit, ato nuk respektojnë as standardin e arsyetimit. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi kjo çështje është hetuar një herë nga Prokuroria e Tiranës, e cila, me vendimin e datës 19.09.2016, ka vendosur pushimin e çështjes, për rrjedhojë gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë nenin 329/c të KPP-së, ndërkohë që raportet e KLSH-së nuk përbëjnë provë të re, pasi në to jepen thjesht mendime, rekomandime që kanë ekzistuar gjatë procedimit të pushuar dhe që janë administruar nga prokuroria edhe në atë kohë.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe pse kërkuesi formalisht ka pretenduar cenimin e një të drejte kushtetuese, siç është ajo për proces të rregullt ligjor, ashtu edhe të parimit kushtetues të sigurisë juridike, pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual kanë të bëjnë, në thelb, me çështjen e të provuarit të fajësisë së kërkuesit, pra me verifikimin nga gjykatat e zakonshme të ekzistencës së elementeve të veprës penale për të cilën ai është akuzuar. Për rrjedhojë, këto pretendime janë të tilla që mund të parashtrihen përpara gjykatave penale gjatë gjykimit të themelit

të çështjes penale, ku kërkuesi ka mundësinë që të paraqesë edhe çdo pretendim dhe provë në kundërshtim të akuzës së paraqitur nga prokuroria, në përputhje me parimet e një procesi të drejtë ligjor, si dhe të marrë përgjegje të arsyetuar nga gjykatat në lidhje me to. Kjo nënkupton edhe se, në drejtim të pasojave të ardhura nga shkelja e pretenduar, kërkuesi nuk ka arritur të provojë përpara Gjykatës se ato janë të tilla që nuk mund të rikuperohen gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale në ngarkim të tij, pra se e bëjnë të parikuperueshme vetë të drejtën kushtetuese të pretenduar të cenuar. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimeve të ndërmjetme të kundërshtuara, për rrjedhojë, se pasojat e shkeljes së pretenduar nuk mund t'i nënshtrohen verifikimit dhe kontrollit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë procesit të gjykimit të themelit të çështjes penale ndaj tij, në kuptim të rolit të tyre subsidiar. Në këtë kuptim, ajo vlerëson se kërkuesi ka mjete të tjera juridike në dispozicion në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual, ndaj ai nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues për kundërshtimin e vendimeve objekt kërkese.

19. Duke pasur parasysh se kriteret e legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues kanë karakter kumulativ, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësisimit të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.